

## KONTRATË SHITBLERJE TË KUOTËS SË KAPITALIT

Sot më datë 24.01.2024, u lidh kjo kontratë midis palëve si më poshtë:

**Në cilësinë e shitësit: Z.Romario MEHMETAJ**, atësia: Gjergji, i datëlindjes 05.12.1996, mbajtës i dokumentit kartë identiteti me numër: 039141297 dhe Numër Personal: J61205055L, lindur në Brataj, Vlorë dhe banues në Vlorë, Njësia Administrative Qendër Vlorë, Babicë e Madhe, Kodi postar 9402; madhor dhe me zotësi të plotë juridike për të vepruar.

**Në cilësinë e blerësit: Z.Armando QAMA**, atësia: Sabri, i datëlindjes 27.09.1994, mbajtës i dokumentit kartë identiteti me numër: 038068004 dhe Numër Personal: J40927075L, lindur në Berat dhe banues në Tiranë, Njësia Administrative DAJT, Rruga: "Muhamet Deliu", Nd.69/2; H.1; LINZË; madhor dhe me zotësi të plotë juridike për të vepruar.

### Neni 1 KUSHTET PARAPRAKE

Kjo kontratë është bazuar në Vendimin e Asamblesë së Ortakëve datë 24.01.2024.

Shitësi: Z.Romario MEHMETAJ, është ortak dhe zotërues i 50% të kapitalit të shoqërisë "Caffe Colombiana" SH.P.K., e cila është 1(një) kuote e kapitalit me vlerën 1 000 000 (një milion) lekë. Shoqëria "Caffe Colombiana" SH.P.K., me NUIS:M32418026A është themeluar më datë 15.12.2023 dhe regjistruar pranë QKB-së më datë 18.12.2023.

### Neni 2 SHITJA E KUOTËS SË KAPITALIT

2.1 Z.Romario MEHMETAJ, në cilësinë e shitësit, nëpërmjet kësaj kontrate, i shet dhe i transferon blerësit Z.Armando Qama, dhe ky i fundit pranon dhe blen kuotën me vlerën 1 000 000 (një milion) lekë, kjo në përputhje me kushtet dhe afatet e përcaktuara në këtë kontratë. Kjo vlerë është paguar nga ana e blerësit dhe shitësi nuk ka pretendim për të.

2.2 Titulli i pronësisë mbi kuotën do të transferohet prej shitësit të blerësit menjëherë, me nënshkrimin e kësaj kontrate.

### Neni 3 DEKLARIME DHE GARANCI TË SHITËSIT

3.1 Shitësi deklaron se është i vetmi pronar dhe titullar i kuotës dhe i të drejtave që rrjedhin prej saj dhe garanton se kuotat janë tërësisht të lira nga cdo peng, privilegj, barrë siguroese, detyrim, garanci apo cdo e drejtë tjetër me favor të të tretëve.

**Neni 4  
TË TJERA**

4.1 Shitësi deklaron se pavarësisht cmimit të shitjes së kuotes në marrëveshje mes paleve, pas kësaj nuk ka asnjë përgjegjësi apo detyrim për kreditë, borxhet, dividendët, detyrime të ortakut dhe situatën financiare të shoqërisë dhe nuk gëzon asnjë të drejtë lidhur me kuotën që transferohet me shitje, në cilësinë e ortakut.

4.3 Blerësi përfitues i kuotës pavarësisht cmimit të blerjes në marrëveshje mes palëve, bazuar në ligje, përgjigjet pas kësaj personalisht për cdo veprim lidhur me kuotën me fjalë dhe vlerën totale të kapitalin nominal të shoqërisë.

**Neni 5  
ZGJIDHJA E MOSMARRËVESHJEVE**

Palët angazhohen të zgjidhin me mirëkuptim cdo mosmarrëveshje që lidhet me interpretimin dhe ekzekutimin e kësaj kontrate dhe vetëm kur një zgjidhje e tillë nuk është e mundur mosmarrëveshja do të kalojë për zgjidhje në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë.

Kjo kontratë, u hartua në gjuhën shqipe, në 3(tre) kopje dhe u nënshkrua nga të dyja palët si më poshtë:

**SHITËSI:**

**Romario MEHMETAJ**

Romario Mehmetaj



**BLERËSI:**

**Armando QAMA**

Armando Qama

